



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 13.05.2014, ora 10:00-10:50

Drejton mbledhjen

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Agron Çela, Andrea Marto, Arben Çuko, Ervin Koçi, Evis Kushi, Gjovalin Kadeli, Luan Duzha, Gledjon Rehovica, Ilir Xhakolli, Majlinda Bufi, Koço Kokëdhima, Paulin Sterkaj, Pjerin Ndreu dhe Përparim Spahiu.

Mungojnë:

Ridvan Bode, Albana Vokshi, Dashamir Shehi, Florion Mima, Liljana Elmazi, Sherefedin Shehu, Edmond Spaho, Jorida Tabaku, Igli Cara dhe Sherefedin Shehu.

Të ftuar:

Ervin Mete – zëvendësministër i Financave

Linda Rusmali – drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Financave

Enkeleda Shehi – kryetare e AMF-së

Teuta Baleta – këshilltare në AMF

Violanda Theodhori – drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike në AMF

Rinald Guri – drejtor i Departamentit të Kërkimit, TI dhe Statistikës në AMF

Gladiola Hysi – specialiste pranë Drejtorisë së Zbatueshmërisë

Elona Sherri – specialiste pranë Drejtorisë së Rregullimit e Standardeve

Fitnete Sulaj – kryetare e Asamblesë, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë

Ejana Xhixha – sekretare e Përgjithshme në Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë

Ardit Hysa – grupi teknik për projektligjin nga Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Fillojmë mbledhjen.

E kemi lënë te neni 28, seksioni 1: “Procedurat e licencimit”.

Neni 28: “Licenca”.

Keni ndonjë gjë për 6 pikat? Nuk keni.

Atëherë, hedhim në votë nenin 28.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 29: “Fazat e licencimit”.

Për pikën e parë keni gjë? Nuk keni.

E hedhim në votim nenin 29.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 30: “Kërkesa për marrjen e miratimit paraprak”.

Ka dikush diçka për pikën 1?

Po, urdhëroni zonja Shehi.

Enkelejda Shehi – Sistemimin këtu te pika 1, germa “i”. Në fakt, germat që vijojnë: “j”-ja dhe “k”-ja kanë qenë nënndarje të germës “i”, domethënë presopozohen të jenë në brendësi, si me thënë, germa “i” përmbledh “j”-në dhe “k”-në dhe pastaj të gjitha spostohen.

Erion Braçe – Po, patjetër. Rakordojeni me sekretarinë!

Ejana Xhixha – Po ashtu, ka një referencë te pika 2.

Erion Braçe – Për pikën 2, pra ndryshon referenca e germës “j” për pikën 1.

Dakord.

Atëherë, për pikën 2 ka vetëm këtë gjë.

Për pikën 3? Nuk ka gjë.

Nga deputetët ka ndonjë gjë? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 30.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 31: “Plani i biznesit”.

Ka ndokush ndonjë gjë? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 31.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 32: “Periudha e shqyrtimit”.

Ka ndokush ndonjë gjë? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 32.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 33: “Miratimi paraprak”.

Keni ndonjë gjë, ju ose deputetët? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 33.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 34: “Refuzimi i miratimit paraprak”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një ndryshim nga Komisioni i Ligjeve.

E hedhim në votim me propozimin e Komisionit të Ligjeve.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 35: “Dhënia e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi”.

Keni ndonjë gjë? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 35.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 36: “Zgjerimi i veprimtarisë”

Keni ndonjë gjë? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 36.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 37: “Raporti i fisibilitetit”.

Keni ndonjë gjë? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 37.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 38: “Informimi për fillimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë së Shoqërisë së Sigurimit”.

Keni ndonjë gjë? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 38.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 39: “Përfundimi i licencës”

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 39.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te seksioni 2: “Lejimi i ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 40: “Ushtrim i i veprimtarisë së sigurimit në një vend të huaj”

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 40.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 41: “Ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit në një vend anëtar”

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni

Hedhim në votim nenin 41.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te seksioni i 3-të: “Ushtrimi i veprimtarisë së sigurimit nga shoqëria e sigurimit të vendit anëtar dhe vendit të huaj”. “Licencimi i degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj”

Keni ndonjë gjë? Nuk keni.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 43: “Shoqëria e sigurimit e vendit anëtar”

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 44: “Zyra e përfaqësimit”

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 44.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Seksioni i 4-të: “Transferimi i portofolit të sigurimit”.

Neni 45: “Transferimi i portofolit të sigurimit”

Keni ndonjë vërejtje apo sugjerim? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 45.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 46: “Kërkesa për transferimin e portofolit të sigurimit”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 47: “Miratimi dhe refuzimi i kërkesës për transferimin e portofolit të sigurimit”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te seksioni i 5-të: “Pjesëmarrja influencuese”.

Neni 48: “Kërkesa për pjesëmarrje influencuese”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 49: “Miratimi i pjesëmarrjes influencuese”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 49.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 50: “Njoftimi paraprak i pjesëmarrjes influencuese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 50.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 51: “Pasojat ligjore të pjesëmarrjes influencuese pa miratim”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 51.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 52: “Kompetencat e Autoritetit”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 52.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te seksioni i 6-të: “Miratime të tjera”.

Neni 53: “Delegimi i funksioneve”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 53.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 54: “Miratimi i delegimit të funksioneve”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 54.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 55: “Mbikëqyrja e ushtrimit të funksioneve të deleguara”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Hedhim në votim nenin 55.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 56: “Bashkimi dhe ndarja e Shoqërisë së Sigurimit”.

Keni ndonjë vërejtje? Nuk keni.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 57: “Miratimi ose refuzimi i ndryshimeve të statutit”.

Keni ndonjë vërejtje?

Po, urdhëroni zonja Xhixha!

Ejana Xhixha – Për sa i përket nenit 57, te pika 2: “Ndryshimet thelbësore të statutit bëhen me miratimin paraprak të Autoritetit”. Kjo është një çështje e diskutuar edhe në Komisionin e Ligjeve. Ideja është për të shmangur burokracitë dhe kohëzgjatjen e panevojshme për ndryshimet në statut. Për ta specifikuar më mirë dispozitën, ne do të sugjerim që ndryshimet e statutit, që kërkojnë 3/5-at e votave, të bëhen me miratimin paraprak të Autoritetit, sepse në formulimin siç është, i bie që edhe për ndryshimin e selisë së shoqërisë të na duhet të marrim miratimin paraprak në Autoritet, gjë që është një procedurë e tejzgjatur dhe burokratike.

Anastas Angjeli – Ka një propozim tjetër, thuhet një afat dhe brenda këtij afati zgjidhen të gjitha problemet. Në qoftë se nuk bëhet në afat për të shmangur burokracitë...?

Ejana Xhixha – Burokraci, në kuptim të miratimit të çdo ndryshimi në statut, pra ndryshimet thelbësore lidhen me ato ndryshime që kërkojnë 3/5-at, sipas ligjit “Për shoqëritë tregtare”, siç janë edhe shoqëritë e sigurimit.

Atëherë, vetë Autoriteti ka parashikuar ndryshimet thelbësore, të cilat janë ato që kërkojnë 3/5-at. Ta specifikojmë: 3/5-at.

Anastas Angjeli – Si bëhet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ejana Xhixha – Të gjitha. Çdo lloj....

Anastas Angjeli - Atëherë përse? Çfarë shqetësimi keni, që duhen vënë në ligj edhe rregulloret?

Ejana Xhixha – Jo rregulloret.

Anastas Angjeli – Ti kishe dy shqetësime.

Shqetësimi i parë është se ka burokraci dhe duhet vënë një afat kohor, dhe është e drejtë.

Shqetësimi i dytë është që në ndryshimet thelbësore të përdoret autoriteti i 2/3-ve të votave, apo jo?

Ejana Xhixha - Jo, jo, vetëm miratimi i ndryshimeve statutore, që bëhen me 3/5-at, të marrin miratimin paraprak në autoritet.

Anastas Angjeli - Kurse ndryshimet e vogla të mos e marrin. Kush mund t'i dallojë tani ndryshimet në statut? Cili akt ligjor ose cila mendje, mund të na thotë ne që ky është ndryshim thelbësor, kurse ky nuk është?

Ejana Xhixha - Janë të përcaktuara kompetencat e asamblesë së aksionerëve kur bëjnë 3/5-at.

Anastas Angjeli - Cili quhet ndryshim thelbësor?

Ejana Xhixha - Për këtë duhet pyetur Autoriteti, si hartues i kësaj dispozite.

Anastas Angjeli – Meqenëse duhet pyetur Autoriteti, t'ia lëmë Autoritetit.

Kështu që brenda afatit të zgjidhim burokracinë.

Erion Braçe – Çfarë afati?

Anastas Angjeli – 10 ditë.

Erion Braçe - Pra, ndryshimet thelbësore të statutit bëhen me miratimin paraprak të Autoritetit brenda 10 ditëve.

Po, urdhëroni!

Lindita Rusmali – Duhet të konsideroni që statuti miratohet nga AMF-ja. Në këtë logjikë, çdo ndryshim i statutit duhet të miratohet.

Erion Braçe – Pra, çdo ndryshim brenda 10 ditëve.

Ejana Xhixha – Lidhur me afatin 10-ditor, pjesa e parë, që është për njoftimin, pra që çdo 10 ditë ka njoftim, jam dakord, ndërsa për punë miratimi, bordi nuk mblidhet dot çdo 10 ditë, por mblidhet 1 herë në muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por, një herë në muaj e ka ligji i AMF-së.

Anastas Angjeli – Mos u shqetësoni se 10 kompani janë. Ato nuk do t'ju sjellin ndryshime çdo 10 ditë. Një herë në vit do t'ju sjellin.

Erion Braçe – Neni 57 me këtë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te kreu i 4-të: “Mbrojtja e konsumatorit”.

Seksioni 1: “Parime të përgjithshme”. “Detyrimet e shoqërisë së sigurimit dhe ndërmjetësit”.

Ka ndonjë vërejtje? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 58.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 59: “Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim dhe pagesat e dëmshpërblimit”

Ka ndonjë vërejtje?

Po, urdhëroni.

Ejana Xhixha – Në nenin 59, pika 4, për ta bërë dispozitën më të qartë: “Kërkesat për dëmshpërblim trajtohen nga siguruesi në kohë, në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe transparente”. Mendojmë se këto janë kritere tërësisht të hapura dhe të pamatshme, ndërsa ne ofrojmë këtë formulim për t’i ardhur në ndihmë konsumatorit në mënyrën më të mirë të mundshme: “Kërkesat për dëmshpërblim trajtohen nga siguruesi.....” në kohë dhe në përputhje me kriteret e miratuara për këtë qëllim, sepse gjatë ligjit del detyrimi i shoqërisë për të hartuar rregullore për procedurat e dëmshpërblimit...

Erion Braçe – Dakord. Do t’ia kaloni sekretarisë së komisionit. Nuk besoj se keni ndonjë gjë.

Anastas Angjeli – Komisioni i Ligjeve ka bërë një shtesë. Jeni dakord me të?

Erion Braçe – Çfarë shtese?

Anastas Angjeli – Neni 59, për pikën 4 të shtohet pika 5 me këtë përmbajtje 5/1. E keni pranuar ju këtë?

Ejana Xhixha – Po. Pas pikës 4, shtohet pika 5. Ne mendojmë që kjo pikë ndoshta e riformuluar, sepse formulimi vjen pak i ashpër ndaj ushtrimit të së drejtës. Si paragjykim duhet të jetë në projektligj, sepse kështu ndërtojmë mekanizmin, si klienti apo policmbajtësi, vjen dhe e ushtron të drejtën e tij për dëmshpërblim. Pra, krijojmë procedurën e kërkuar nga ligji. I siguruari me ndodhjen e ngjarjes së siguruar, gëzon të drejtën dhe nëse vendos ta ushtrojë atë, e bën duke paraqitur kërkesën për dëmshpërblim te siguruesit, në mënyrë që ne të krijojmë procedurën që kur ndodh ngjarja e sigurimit dhe fiton të drejtën për dëmshpërblim, pikë së pari, duhet t’i drejtohet kontraktorit të vetë dhe pastaj të ndjekë pjesën tjetër të...

Anastas Angjeli – Kjo është shumë e drejtë, por si veprohet sot?

Ejana Xhixha – Sot nuk ka një parashikim të tillë. Kjo procedurë mungon. Ka dy mënyra si funksionon sot ushtrimi i së drejtës:

E para, i drejtohet shoqërisë siguruese.

E dyta, në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa kontaktuar me shoqërinë i drejtohet gjykatës.

Anastas Angjeli –Kush ia jep këtë të drejtë? Ia jep ligji, apo jo?

Kjo pika që ju shtoni vjen në ndihmë të konsumatorit.

Ejana Xhixha – U vjen në ndihmë të gjitha palëve të përfshira, edhe shoqërisë së sigurimit, edhe rregullatorit, sepse në mënyrë të menjëhershme shoqëria informohet për numrin dhe masën e dëmit.

Anastas Angjeli – Keni ndonjë gjë që ju shqetëson këtu, sepse kjo është pjesë e kontratës?

Violanda Theodhori – Ne jemi dakord në parim me këtë ndërhyrje shtesë, por duam që të hiqet fjala “dhe ka detyrim ligjor të paraqesë kërkesën”. Pra, i siguruari me ndodhjen e ngjarjes së siguruar gëzon të drejtën të shkojë dhe të kërkojë dëmshpërblimin, por jo detyrimi ligjor, sepse po të dojë ai shkon dhe e kërkon. Detyrimin për të kërkuar dëmshpërblimin është parashikuar edhe në Kodin Civil dhe ka një afat 2-vjeçar. Fjala “menjëherë” mund të interpretohet keq, sepse shoqëritë e sigurimit kërkojnë që nëse nuk vjen menjëherë nuk ia jep më.

Ejana Xhixha – Jemi dakord me pjesën e Kodit Civil, që parashikon të drejtën e parashkrimit, është periudha 2-vjeçare. Jemi shumë të qartë për këtë pjesë. Problemi është nëse ne themi “gëzon të drejtën”, avokati i tij thotë...,sepse ideja është që projektligji zgjidh edhe problematikën gjyqësore. Pra, nuk duhet parë thjesht në këndvështrimin tonë si operatorë apo të autoritetit. Duhet parë edhe praktika gjyqësore që në kushtet shqiptare dhe në mënyrën si funksionon gjyqësori në Shqipëri janë shumë problematike dhe është mirë që ligji t’u përgjigjet këtyre problematikave.

Anastas Angjeli – Në qoftë se unë si klient nuk dua ta ushtroj këtë të drejtë, ti më detyron ta ushtroj?

Ejana Xhixha – Jo, nëse vendos ta ushtrojë këtë të drejtë, hapi i parë të jetë kërkesa ndaj kompanisë, në mënyrë që ai të vijë...

Anastas Angjeli – Unë po pyes për mënyrën e ushtrimit të së drejtës sime është vullnetare apo e imponuar?

Ejana Xhixha - Ai e gëzon të drejtën në bazë të kontratës.

Anastas Angjeli – Neni miratohet siç është me ato ndryshimet...

Ejana Xhixha - Domethënë, riformulimi kështu, nuk e zgjidh problemin.

Anastas Angjeli – Jemi dakord.

Erion Braçe – Votojmë nenin 59 me këtë ndryshim.

Kush është dakord me nenin 59? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 60, detyrimi për informim.

Kush është dakord me nenin 60? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 61, parimet e përgjithshme të detyrimit për informim.

Kush është dakord me nenin 61? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 62, pasojat juridike në rast të mospërmbushjes së detyrimit për informim.

Kush është dakord me nenin 62? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Nenin 63, detyrimi për informim përpara nënshkrimit të kontratës.

Kush është dakord me nenin 63? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 64, informacioni i detyrueshëm, kushtet e kontratës.

Kush është dakord me nenin 64? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 65, përmbajtja e njoftimit.

Kush është dakord me nenin 65? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Seksioni tre, informimi i publikut.

Neni 66, informimi i publikut.

Kush është dakord me nenin 66? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 67, veprimtaria promicionale.

Kush është dakord me nenin 67? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 68, detyrimi i shoqërisë së sigurimit.

Po, urdhëroni!

Ejana Xhixha – Te neni 68, kemi një parashikim në pikën 2, ku thotë: “Çdo informacion promocial i njoftohet autoritetit përpara publikimit të tij”, dhe në pikën 3 kemi këtë dispozitë: “Autoriteti mund të hartojë rregulla për procedurën e njoftimit, korrigjimit apo ndalimit të informacionit promocial”. Ndërkohë, po t’i referohemi nenit 67, pika 2 themi: “Shoqëria e sigurimit është përgjegjëse për publikimin e informacioneve sipas kriterëve të paragrafit 1 të këtij neni”, që do të thotë se shoqëria, sipas ligjit është institucion përgjegjës për publikimin dhe vërtetësinë e lajmit publicitar promocial që ajo shfaq, por detyrimi për të miratuar paraprakisht një material publicitar në autoritet, kur ndërkohë, autoriteti gëzon të drejtën, sipas pikës 3, për të hartuar rregulla për korrigjimin apo ndalimin e informacionit promocial, mendoj se është e ekzagjeruar, që për çdo material publicitar, që është e drejta minimale e ushtrimit të një aktiviteti tregtar të marrë miratimin e autoritetit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Ka ndonjë gjë Autoriteti?

Enkeleda Shehi – Ne e gjykojmë që duhet të jetë. Autoriteti është institucioni ku bëhet miratimi i informacionit të tillë. Lidhur edhe me tregjet e tjera që kemi: tregjet e pensioneve dhe tregjet e letrave me vlerë, kemi ndjekur po këtë procedurë. Nuk besoj se për të parandaluar edhe *Misselling*, sepse edhe kompanitë në të gjitha mediat mund të shpërndajnë informacionet, të cilat autoriteti duhet t’i ketë në dispozicion përpara dhe jo të rrijë t’i vëzhgojë pastaj dhe t’i marrë ato kur të jenë shfaqur dhe të kenë desinformuar publikun.

Erion Braçe – Që t’ju njoftohet është dakord, por që autoriteti mund të hartojë rregulla për procedura njoftimi, korrigjimi dhe ndalimi të informacionit profesional është pak si shumë. Që ju të merrni një informacion promocial nuk është aspak problem që kompania...

Anastas Angjeli - Dhe ju në qoftë se vëreni se ata shkelin...

Enkeleda Shehi – Pikërisht kjo është që ne ta kalojmë si filtër ne përpara...

Erion Braçe – Ajo buron nga neni i mëparshëm.

Enkeleda Shehi – Është një treg financiar dhe nëse ka ndodhur dëmi, le të themi, janë njoftuar klientët për një produkt, që nuk është ai që reklamohet, pasoja është më pas, plus edhe reputacioni i imazhit. Kështu që ne mendojmë se është e rëndësishme për të mbrojtur klientët dhe ne të jemi të informuar dhe të përcaktojmë mënyrën si do të jepet ky informacion te klienti. Kjo është një praktikë e njohur edhe në legjislacionet e tjera të cilave u jemi referuar.

Komisioni i Ligjeve ka bërë këtë ndryshim ka hequr fjalën “procedurë”, domethënë autoriteti mund të hartojë rregulla, në lidhje me njoftimin, korrigjimin apo ndalimin e informacionit profesional. Kurse pika 2 na shfaqet tani për herë të parë.

Anastas Angjeli – Jo pika 2, konsiderohet të hiqet dhe në pikën 3 autoritetit i lihet në kompetencë të hartojë rregullat për procedurën e njoftimit, korrigjimit apo ndalimit të informacionit promocional. Kështu ka ardhur.

Enkeleda Shehi – Në versionin tonë kemi që pika 3 të hiqet. Megjithatë mund të jetë shtuar më mbrapa...

Anastas Angjeli – Këtu bëhet fjalë, që pika 2 të hiqet dhe pika 3 të riformulohet duke ju lënë juve të gjitha të drejtat që kërkonit më përpara. Ju prish ndonjë punë kjo gjë?

Doni t’jua lexoj? Ajo që kam unë përpara është: “Neni 68, pika 2 sugjerohet të hiqet dhe në pikën 3 është : “Autoritetit i lihet në kompetencë të hartojë rregullat për procedurën e njoftimit, korrigjimit apo ndalimit të informacionit promocional”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Violanda Theodhori – Problemi është se nëse në linjë nuk ka një dispozitë të posaçme që shoqëritë apo ndërmjetësit detyrohen të bëjnë njoftim në autoritet ne... Nuk mund të dalim me rregullore, pra duhet njoftim dhe autoriteti të nxjerrë rregulla si do të vijë ky njoftim, do të vijë 10 ditë përpara, një muaj përpara, sepse nëse nuk thuhet fjala “njoftim”...

Ku del e drejta?

Anastas Angjeli – Ai do të zbatojë rregullat që do t’i dërgosh ti. Në qoftë se konstaton se ai nuk i ka zbatuar rregullat që ti ke nxjerrë që t’i ka dhënë ligji, ti ke të drejtën tënde.

Violanda Theodhori – Unë do të propozoj: “autoriteti mund të hartojë rregulla për njoftimin e publikimit të informacionit promocional për korrigjimin apo ndalimin e përhapjes së këtij informacioni”, të jetë më i saktë titulli i rregullores.

Ardit Hysa – Kjo pikë informacioni promocional është një hapësirë shumë e gjerë. Fillon nga fletëpalosjet, nga reklamat në media në gazeta. Pra, është një tërësi. Funksionet që merr autoriteti në këtë rast e tejkalojnë disi funksionin mbikëqyrës rregullativ dhe futet në një funksion administrativ dhe pa dashur ta banalizoj mund të diskutojmë për ngjyrat e reklamave.

Unë mendoj që për elementet thelbësore që prekim mediet, autoriteti mund të vihet në dijeni më përpara dhe të kërkohet një konfirmim nga autoriteti, por për çdo material promocional është pak e tepërt. Autoriteti i ka të gjitha instrumentet që të ndalojë një reklamë të tillë me pikën 3.

Anastas Angjeli – Ku e ka këtë të drejtë?

Ardit Hysa – Te pika 3 ku thotë “rregullat, procedurat, korrigjimin apo ndalimin e informacionit promocial”.

Ejana Xhixha - Pra te pika 3 parashikohet e drejta e autoritetit që në qoftë se gjen materialin publicitar me informacion jo të saktë apo të dëmshëm, ai mund të përcaktojë procedurat si e tërheq këtë material publicitar.

Rinald Guri – Qëllimi i kësaj është parandalimi. Domethënë kuptohet që mund të ketë sasi informacioni... por është parandalim, sepse mesazhi promocial është kontakti i parë që konsumatori ka me shoqërinë e sigurimit. Pra, neni që iu referua, pikat 1 dhe 2 të nenit 67, thuhet: “Shoqëria duhet të përmbajë të dhëna të qarta dhe të vërteta e të plota dhe autoriteti verifikon se çfarë mesazhi i jepet publikut.” Nëse është mesazh keqinformues e parandalon. Ky është qëllimi.

Anastas Angjeli – Në nenin 68 hiqet pika 2 dhe sugjerohet që pika 3 të jetë: “Autoritetit i lihet në kompetencë të hartojë rregulla për procedurën e njoftimit”. Këtë doje ti?

Violanda Theodhori – Ta heqim meqenëse e ka thënë edhe Komisioni i ligjeve. Njoftimi para publikimit.

Anastas Angjeli – Të njoftohen dhe pastaj janë korrigjimi,...

Mbajeni shënim, Alma.

Erion Braçe – Bie pika 2 riformulohet pika 3, siç e citoi zoti Angjeli.

Kush është dakord me nenin 68 me këtë ndryshim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 69, ankimimi.

Ejana Xhixha – Dua të bëj një saktësim të vogël te pika 6. Fjalja e dytë “autoriteti brenda kompetencave të tij mbikëqyrëse ka të drejtë të kontrollojë nëse shoqëria e sigurimit zbaton praktikën më të mirë rregullat profesionale, kërkesat e ligjit dhe kushtet e kontratës së sigurimit.”, Ne sugjerojmë që të jetë “nëse shoqëria e sigurimit zbaton kërkesat e ligjit dhe kushtet e kontratës.”

Anastas Angjeli – Nuk ka ndonjë problem, mjafton të jetë ligji dhe kontrata dhe jemi në rregull.

Erion Braçe - Vazhdojmë me këtë riformulim të nenit 69, që sapo u tha.

Kush është dakord me nenin 69? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 70, zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

Kush është dakord me nenin 70? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Sekreti profesional. Seksioni të dhënat konfidenciale.

Neni 71, konfidencialiteti.

Kush është dakord me nenin 71? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 72, detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit.

Pika 1 është e ngatërruar. Anëtarët e këshillit administrativ...

Anastas Angjeli – Cili nen?

Erion Braçe – Neni 72. Funkionarë kryesorë, drejtorët, aksionarë, të punësuar dhe çdo person tjetër i shoqërisë ,i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij përdor të dhënat e përcaktuara në nenin 71 të këtij ligji, si dhe byroja shqiptare e sigurimit nuk duhet të japë ato palëve të treta të përdorë...

Është e qartë. Fjala është e ndarë me presje. Është në rregull.

Kush është dakord me nenin 72? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 73, përdorimi i të dhënave personale.

Kush është dakord me nenin 73? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 74 rregullat e administrimit të rrezikut.

Kush është dakord me nenin 74? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 75, kapitali i shoqërisë së sigurimit.

Ejana Xhixha – Vërejtje nuk kemi, por Komisioni i Ligjeve ka propozuar një riformulim, për sa i përket çështjes së akteve nënligjore që diskutuam në fillim që ndoshta aktet nënligjore të nxjerra nga autoriteti do të zëvendësohen me fjalën “rregullore” apo si e lamë.

Erion Braçe – A e bëtë riformulimin që ramë dakord dje?

Atë do të reflektojmë edhe këtu.

Kush është dakord me nenin 75? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 76, kapitali bazë.

Kush është dakord me nenin 76? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 77, kapitali shitesë.

Kush është dakord me nenin 77? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 78, investimet.

Kush është dakord me nenin 78? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 79, elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit.

Kush është dakord me nenin 79? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 80, seksioni i tretë, mjaftueshmëria e kapitalit. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese.

Kush është dakord me nenin 80? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 81, fondi i garancisë.

Ka vërejtje?

Po, urdhëroni!

Ejana Xhixha – Te neni 81 ne kemi një riformulim për pikën 3, ku kërkojmë që parametrat financiarë të fondit të garancisë për të gjitha klasat e sigurimit të mbeten të pandryshuara, siç janë në ligjin aktual për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit. Kjo për disa arsye:

E para, shoqëritë e sigurimit dhe tregu në përgjithësi gëzojnë të njëjtat parametra tekniko - financiarë dhe nuk shikojmë arsye pse ta ndryshojmë.

E dyta, ka të bëjë me rritjen e tregut apo gjendjen e pritshmërisë së tij. Ne shikojmë që tregu ka të njëjtin trend, nuk është se kanë një rritje, madje në vitin 2013 është konstatuar një rënie e lehtë e tij dhe nuk konstatojmë ndonjë argument teknik se përse duhet rritur. Po të shikojmë këtu edhe zhvillimin e munguar në atë pjesë, siç janë shoqëritë e risigurimit apo të jetës, çështja bëhet pak më e komplikuar t'u kërkojë të rritet kapitali për shoqëritë, që në totalin e tregut, zënë një peshë shumë specifike. Kështu që ne sugjerojmë që pika 3 të mbetet e pandryshuar, siç është në ligjin aktual dhe fondi i garancisë në shoqëritë e jo jetës të jetë, jo më i vogël...

Erion Braçe – Në rregull, ka ndonjë vërejtje Autoriteti?

Rinald Guri – Në ligjin aktual fondi i garancisë për klasën 10 – 15, është 370 milionë lekë. Me këtë shifër është bërë në vitin 2007, dhe është presupozuar të jetë 3 milionë euro. Ndryshimet që janë bërë në këtë ligj janë si pasojë e ndryshimit të kursit të euros në këto vite. Nuk mund ta shprehim

në ligj që kapitali minimal është 3 milionë euro, aq sa e kërkojnë direktivat, por 3 milionë euro bëjnë më shumë se 370 milionë lekë. Duke parë tendencat e kursit në vite, jemi para faktit që leku mund të zhvlerësohet ndaj Euros, gjë që e ul përsëri fondin e garancisë.

Desha të bëj një sqarim: ky është kapital fillestar për hapjen e një kompanie sigurimi dhe është përcaktuar si vlerë absolute nga direktivat. Pra, nuk mund të themelosh një kompani sigurimi me më pak se kaq. Pra, performanca dhe aktiviteti lidhen me kapitalin rregullator, që është kapitali gjatë veprimtarisë. Këto janë dy gjërat që duhen veçuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

120 – 126, është e llogaritur dhe mund t'ju sjell dhe kalkulimet tona. 1 euro ka qenë 123 -126 lekë nuk jam shumë i sigurt. Ka ndryshuar me 20 pikë. Kemi bërë llogaritjet, që kemi dalë me këtë shifër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkeleda Shehi – Në fakt, duke parë dhe situatën makro, e mbështesim shqetësimin që kanë shoqëritë në lidhje me fondin e kapitalit, sepse është një fond që do ta ruajnë aq sa e kanë tani, domethënë, nuk do t'u sjellë implikime financiare nëse bëhet ky ndryshim.

Duke parë tendencën si do të shkojë ky tregues në të ardhmen, do të propozonim të shtonim një pikë tjetër në këtë nen, ku t'i japim mundësi Autoritetit, siç e kemi dhënë edhe në ligjin e pensioneve, apo te ligji i fondit të investimeve, që nëse kursi ndryshon më shumë se një përqindje e dhënë, automatikisht shoqëria duhet ta përshtatë. Pra, të vëmë një formulë, apo një modalitet që në qoftë se zhvlerësimi është shumë i madh, të mos reflektojë aq shumë në fondin e garancisë, t'i japim një marzh këtij komponenti.

Ndërkohë, që ka diçka: propozimi aktual që kemi bërë, kërkon një periudhë përshtatjeje 2-vjeçare, domethënë: këtë fond garancie do ta kenë pas 2 vjetësh, nuk do të hyjë në fuqi menjëherë. Këto kanë qenë sugjerimet tona, për të lehtësuar reagimin e kompanive, në lidhje me ndryshimin e fondit të garancisë.

Ardit Hysa – Marrëdhënia me fondin e garancisë është një marrëdhënie që lidhet me riskun e tregut të sigurimit. Aktualisht tregu i sigurimit për jo jetën në Shqipëri, është në nivelin 53-54 milionë euro dhe fondi i garancisë i ngurtësuar nga të gjitha kompanitë, është në nivelin rreth 27 – 28 milionë euro. Pra, marrëdhënia e këtij fondi garancie që shërben si kapital me totalin e primeve, të ardhurave që gjenerohen është në nivelin mbi 50%. Kjo e bën joefektiv përdorimin e këtij fondi garancie. Fondi i garancisë në nivelin 2-3 milionë euro, aq sa e kërkon direktiva. Ka një marrëdhënie me aftësinë paguese

dhe aftësitë paguese në tregje të mëdha ku aplikohet direktiva si në Gjermani, Austri, Francë etj., është i pakrahasueshëm me tregun e sigurimeve shqiptare, ku ne konsumojmë për sigurimin e jetës rreth 18 euro në vit, ndërkohë, në vendet si Gjermania shkon rreth 2800 euro në vit për frymë. Krahasimi është i papërshtatshëm dhe risku që merret për të është i papërshtatshëm. Argumenti që ky fond garancie shërben për të mbuluar risqet e akumuluarat nuk qëndron, sepse fondi i garancisë është elementi i fundit që do të përdoret në rast se kompania ka probleme që mund të çojnë në falimentim, apo në likuidim.

Deri tani ne s'kemi prova, fatmirësisht, në tregun shqiptar të përdorimit të këtij fondi garancie, për të mbuluar detyrimet që vijnë nga një proces likuidimi apo falimentimi dhe vetë propozimi nuk është i njëjtë me vlerën e 3 milionë eurove në lekë.

Ka një argument tjetër që primet janë kryesisht në lekë dhe dëmet paguhen në lekë: përdorimi i kursit të këmbimit dhe luhatjet e tij, që në periudha të ndryshme janë të ndryshme. Ka periudha kur leku forcohet dhe nuk është e nevojshme të bëhet indeksim.

Rinald Guri - Mund të bëj një sqarim. Fondi i garancisë nuk është kapital i bazuar në risk, por është kapital ose barrierë për të hyrë në një treg dhe nuk janë primet matëse. Po të kalojmë në logjikën që nëse shoqëria ka pak prime, do të ketë pak kapital, lëmë pas dore ekspozimin. Me pak prime, shoqëria mund të ekspozohet në rritje ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Pastaj, mund të thoni që kjo s'e kufizon tregun?

Rinald Guri – Ky është kapital fillestar për të hyrë në tregun e sigurimeve. Le të marrim një shembull konkret: Shoqëria e sigurimeve nuk mund të mbajë më shumë...

Erion Braçe – Fondi i garancisë është kapital fillestar?

Rinald Guri – Po, ky është kapital fillestar për të filluar dhe gjatë veprimtarisë ky kapital, mund të jetë më i madh ose më i vogël.

Anastas Angjeli – Ka një propozim të atyre, keni edhe ju momentet tuaja, ka edhe një propozim të Komisionit të Ligjeve, kush e do tjetër fjalën?

Ervin Mete - Para se ligji të mbërrinte në komision, ne kemi pasur diskutime me AMF-në dhe me shoqatën dhe 2 kanë qenë kërkesat kryesore të shoqatës:

- administrimi me dy nivele;
- mos rritja e fondit të garancisë.

Për të qenë bashkëpunues dhe duke pasur parasysh situatën e tregut, ne e kemi marrë parasysh dhe kemi thënë që mund të qëndrojë, por duhet edhe një masë tjetër që të mund të na garantojë në raport me ndryshime të mëdha.

Erion Braçe – Çfarë propozoni për masën tjetër?

Ervin Mete – Ky është propozimi në lidhje me kursin. Mund të qëndrojë edhe kështu, siç është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, për të përmbushur një kërkesë, le të qëndrojë, por duhet reflektuar një ulje edhe te marzhi i ulët, se marzhi i poshtëm dhe marzhi i sipërm janë të lidhur me njëri – tjetrin.

Erion Braçe – Po thoni të reflektojë edhe ligjin ekzistues?

Ervin Mete – Po, se këto janë të lidhura me njëra tjetrën.

Erion Braçe – Në rregull. Miratohet me ndryshimet dhe riformulimin që ka bërë Komisioni i Ligjeve.

Ervin Mete – Te propozimi i Komisionit të Ligjeve nuk është marzhi i poshtëm.

Ejana Xhixha - A mund ta lexojmë pak vetëm riformulimin që të jemi të qartë se për çfarë kemi rënë dakord?

“3. Pavarësisht nga përcaktimet në pikat 1 dhe 2, të këtij neni:

a) fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi jo jete nuk mund të jetë më i ulët se 330 milionë lekë. Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të seksionit A, të aneksit I, të këtij ligji, fondi i garancisë nuk mund të jetë më i ulët se 370 milionë lekë;

b) fondi i garancisë së një shoqërie sigurimi nuk mund të jetë më i ulët se 370 milionë lekë, nëse shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi të jetës, sipas klasifikimit të seksionit B, të aneksit I, të këtij ligji;

c) fondi i garancisë së një shoqërie risigurimi nuk mund të jetë më i ulët se 615 milionë lekë;

ç) kufiri minimal i fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit që mbulon rreziqet e disa klasave të sigurimit të jo jetës duhet të jetë i barabartë me vlerën e kufirit minimal të fondit të garancisë të klasës së sigurimeve, për të cilin është parashikuar kufiri më i lartë;

d) kufiri minimal i fondit të garancisë së shoqërisë së sigurimit që mbulon më shumë se një nga veprimtaritë e përmendura në pikat “a”, “b” dhe “c”, të këtij paragrafi, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duhet të jetë i barabartë me vlerën e kufirit minimal të fondit të garancisë së klasës së sigurimeve, për të cilin është parashikuar kufiri më i lartë, në përputhje me klasat për të cilat shoqëria është e autorizuar.”

Ky është parashikimi fjalë për fjalë, siç është në dispozitën aktuale të nenit 98, të ligjit 9267.

Erion Braçe – Kalojani sekretarisë së komisionit!

Përparim Spahiu – Unë kam një shqetësim: nëse ne jemi në tre nivele dhe sigurimi është 18 dollarë për frymë, nëse kemi shtesë produktesh të kompanive të sigurimit, ky fond mund të rritet. Apo s'ka lidhje?

Ardit Hysa – Risku prezantohet në aftësinë paguese. Nëse aftësia paguese është më e madhe se fondi i kërkuar i garancisë, atëherë do të mbahet aftësia paguese si fond garancie. Automatikisht, fondi ndryshon.

Erion Braçe – Hedhim në votim nenin 81 me riformulimin, që sapo u bë.

Rinald Guri – Te riformulimi, pika “d”, përveç vlerave të kapitalit ka një ndryshim thelbësor: një shoqëri sigurimi që kryen disa aktivitete është e përcaktuar që fondi i garancisë të jetë shumatore e aktiviteteve, ndërkohë, që te riformulimi kjo bie poshtë. Kjo është gjë tjetër, përveç vlerave. Domethënë që mbetet propozimi i AMF-së.

Pra, nëse ka jetë dhe jo jetë, mblihet $a+b$. Nëse ka jetë plus risigurim, mblihet $b+c$. Domethënë s'mund të ketë 1 fond garancie për disa aktivitete. Kjo është pikë tjetër. Pika “d” nuk duhet të ndryshohet. Nëse flasim për një vendim në nivel shifrash është gjë tjetër, në nivel aktiviteteve është gjë tjetër.

Anastas Angjeli – Si zbatohet sot?

Rinald Guri – Ndërkohë që pika 615 milionë, që u dha për shoqëritë e risigurimit, nuk është në përputhje me direktivat, është më e lartë se shifra e direktivave.

Ejana Xhixha – Ajo shifër është te ligji aktual.

Ervin Mete – Unë po flas se çfarë kam te direktivat. Ne kemi marrë 420 milionë sipas direktivave dhe shifra 615 milionë është më e lartë se direktiva.

Ejana Xhixha – Meqë iu referuam logjikës për ta mbajtur të pandryshuar pjesën e fondit të garancisë ne i jemi referuar në propozim, niveleve që parashikon neni 98 aktual i ligjit 9267. Riformulimi i pikës “d”, që ju i referoheni si shumatore, është pikërisht e njëjta gjë që parashikohet në fondin e garancisë, pra që nuk parashikohet si shumatore.

Rinald Guri – Dakord, por logjika ishte që kapitali është i lartë dhe të mos e ndryshojmë ligjin aktual.

Anastas Angjeli – Debatet profesionale zgjidhni me njëri-tjetrin pas mbledhjes. U votua që neni 81 të mbetet kështu. Po të kemi ndonjë gjë para se të vemi në seancë zgjidheni dhe na thoni. Vazhdojmë me nenin 82. Ka ndonjë sugjerim?

Ejana Xhixha – Jo.

Anastas Angjeli – Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 83, “Plani i rimëkëmbjes financiare”.

Ka ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 84, “Administrimi i likuiditetit”. Ka ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 85, “Llogaritja dhe raportimi”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 86, “Ndalimi i shpërndarjes së fitimit”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 87, “Primi i sigurimit të jo jetës”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 88, “Primi i sigurimit të jetës”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 89, “Provigjonet teknike”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 90, “Provigjonet për primet”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 91, “Provigjonet për bonuse dhe rabate”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka, sepse është edhe në ligjet e tjera.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 92, “Provigjonet teknike të dëmeve”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 93, “Provigjonet matematike”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 94, “Provigjoni i barazimit të dëmeve”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 95, “Provigjone të tjera teknike”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 96, “Aktivitete në mbulim të provigjoneve teknike”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 97, “Lloji i investimeve të lejuara të aktiveve, në mbulim të provigjoneve teknike”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Ervin Mete – Kam një propozim teknik, duhet shtuar: “dhe”...

Anastas Angjeli – Sekretaria ta mbajë shënim aty ku duhet shtuar: “dhe”!

Neni 98, “Përputhja e investimeve”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 99, “Përdorimi i instrumenteve financiare derivative”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 100, “Mbulimi i kërkuar”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 101, “Mbulimi i kërkuar”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 102, “Detyrimi për të mbajtur veçmas aktive në mbulim të provigjoneve matematike”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 103, “Lloji i investimeve të lejuara të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 104, “Investimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve të veçanta për klasat e sigurimeve ku i siguruari mban rrezikun e investimit”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 105, “Ndarja e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike nga aktivet e tjera të shoqërisë së sigurimit”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 106, “Llogaria e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 107, “Veçimi i investimeve në tituj”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 108, “Investimet në depozita bankare dhe hua”.

Ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Mbledhja mbyllet!

Do të vazhdojmë nesër në orën 10:00 me Seksionin 9, nenin 109.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen!

MBYLLET MBLEDHJA

